

Pjesa përshkruese e Planit të Performancës së Inspektoratit të Punës

Përmbledhje Ekzekutive

Me qëllim të përmbushjes së misionit të tij, Inspektorati Punës synonë të realizojë objektivat e parapara në kuadër të planit të performancës për vitin 2023.

Fuqizimi i Inspektoratit të Punës;

Avancimi i luftës kundër informalitetit, siguria dhe shëndeti në punë;

Përmirsimi i aftësive profesionale të stafit të IP-së;

Avancimi Teknologjisë Informative;

Ngritja transparencës dhe marrëdhënia me publikun.

Agjencia Inspektorati Punës për vitin 2023 ka të punësuar gjithsejtë 64 të punësuar si dhe buxhetin e përgjithshëm prej 1.292.332.3 Euro, me synimin që numri i të punësuarëve të shtohet edhe për 100 Inspektor të punës si dhe 9 pozita në administratë me qka Inspektorati punës synon që të kompletohet me staf për të kryer të gjitha funksionet si Agjenci Ekzekutive brenda fushëveprimtaris së tij.

Përveç buxhetit të lejuar për vitin 2023, Inspektorati punës synon të të zhvillojë aktivitete të atilla të cilat do të mundësonin marrjen edhe të ndihmës nga donatorët, ndihmë e cila do të konsistonte në ofrimin e ndihmës për trajnimet specifike të planifikuara në planin për trajnim të stafit për vitin 2023, për të cilat kërkohet expert nga jashtë si dhe marrja e ndihmës dhe përkrahjes nga fusha e TI-së.

2. Hyrje

Plani i Performancës për vitin 2023, është përgatitur bazuar në nevojën për fuqizim më të madh të rolit të Inspektoratit të Punës, dhe në zbatim të fushëveprimtarisë dhe mandatit ligjor të institucionit.

Inspektorati Punës është institucion shtetëror i pavarur, i themeluar në bazë të Ligjit Nr.200/9 dhe është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit nga fushat e marrëdhënis së punës, siguria dhe shëndeti në punë si dhe të ligjeve të tjera të cilat i mbikqyr sipas përcaktimit në ligjet respektive .

Objektivat e përcaktuar për vitin 2023, ofrojnë mundësi për fuqizimin e IP-së në përputhje të mandatit të dhënë ligjor dhe përgjegjësi kryesore që i janë përcaktuar në raport me mbikëqyrjen e fushave që ka autorizimit ligjor duke ndikuar në rritjen e cilësisë e cila do ndikojë edhe në rritjen e besueshmërisë në këtë Institucion.

Objektivat për vitin 2023, të cilat planifikohen të realizohen janë objektiva gjithëpërfshirëse, po aq edhe specifike me nevojat dhe gjendjen në IP,

Për realizimin e këtyre objektivave në kuadër të planit janë përcaktuar afatet, aktivitetet dhe njësitë apo personat përgjegjës për realizimin më të mirë të këtij plani.

Për hartimin e këtij dokumenti, IP ka zhvilluar konsultime brenda IP me të gjitha njësitë përgjegjëse, duke analizuar edhe performancën aktuale në raport me fushëveprimin e tij.

Po ashtu përgjatë hartimit të këtij dokumenti është marr për bazë gjendja faktike nga të dhënat që posedon IP me qëllim që në këtë plan të përfshihen të gjitha nevojat dhe të adresohen për zgjidhje të gjitha qështjet të cilat secila nga këndi vetë ka paraqitur pengës në punën e IP-së, dhe po ashtu gjatë hartimit të këtij plani janë marr për bazë të gjitha sfidat dhe rreziqet që mund të paraqiten gjatë zbatimit të këtij Plani.

Për realizimin e objektivave, përveq bazimit në Buxhetin vetanak është përfshirë apo paraparë edhe ndihma që ofrohet nga IKAP në fushën e trajnimeve, ndihma nga institucione tjera publike si dhe me theks të veçant, target do të jenë gjetja e donatorëve.

Sfidat kryesore të identifikuara që mund të paraqiten në realizimin e Planit të Performancës janë kryesisht në mungesën e mundshme të buxhetit, e që ndërlidhet me sigurimin e hapsirave të mjaftueshme të punës, mejtet e punës: si vetura të tjera dhe kalimi nga inspektimi manual në E-inspektimi.

Sfidë në vete po ashtu mund të paraqitet edhe nevoja e madhe për hartimin e rregullores së brendshme për organizimin e IP-së konforme me legjislacionin në fuqi e cila përveq si kërkesë ligjore është e nevojshme edhe për ndertimin dhe kompletimin e të gjithë mekanizmave të nevojshëm që në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojnë në realizimin e aktiviteteve të IP-së.

Po ashtu si sfidë tjetër është procedura e rekrutimit të 100 inspektorëve të rinjë të planifikuar të angazhohen në vitin 2023 kjo për arsye se e tërë procedura varet nga MPB-DMZP.

Në saje të sfidave të identifikuara më lartë, rreziku kryesor mbetet mungesa e buxhetit për disa aktivitete që do të paraqiste vështirësi serioze në realizimin e plotë të këtyre aktiviteteve, ndërsa evitimi i këtyre sfidave dhe rrezikut do të eliminohej përmes ndihmës së marr nga donatorët, ndihmë kjo që do të mundësonte realizimin e aktiviteteve të IP-së duke jetësuar në parim misionin e IP-së për të krijuar kushte për punë të sigurtë dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet.

Përmbledhje e Objektivave

Objektivat e përcaktuara në përmbledhjen ekzekutive, përfshijnë aktivitetet konkrete për vitin

2023. Në kuadër të kësaj, IP do të përgadisë sipas nevojës edhe Plane të veprimit, të cilat do të ndihmonin arritjen e objektivave në vijim:

Objektivi I: Fuqizimi rolit të IP-së

Në këtë objektivë synohet fuqizimi i rolit të IP-së në fusha të cilat janë targetuar në kuadër të kësaj objekteve, nevoja për vendosjen dhe realizimin e kësaj onjektive është detrmnuar nga, informatat dhe gjendja faktike për brenda IP-së, fakte këto me të cilat është ballafaquar IP gjatë vitit paraprak.

Problemet të cilat pritet të adresohen përmes kësaj objekteve konsistojnë kryesisht në bashkëpunimin më të mirë me partnerët social, sigurimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve me donatorë, sigurimin dhe krijimin e kushteve më të mira për punë brenda IP-së, siguri hapsirave të punës dhe njeteve tjera për punë, krijimin e një metodologjie pune për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kompanive me risk të lartë për tu inspektuar duke përfshirë edhe sigurimin e stafit profesional për këtë proces, duke bërë fillimisht vizita studimore, dhe bashkëpunime me Institucione që kanë ndërtuar sistem nga kjo fushë brenda dhe jashtë vendit, zhvillimi i procesit të klasifikimit të pozitave të punës në IP dhe hartimi i Rregullores për organizimin e brendshëm po ashtu është një faktor me rëndësi, prandaj realizimi i kësaj objekteve është i një rëndësie të madhe pasi që pritet të adresojë probleme të cilat do të kishin ndikim shumë të madhë në forcimin e IP-së.

Aktivitetet të cilat do të realizohen për realizimin e kësaj objekteve janë:

- Bashkëpunimi me partnerët social dhe donatorë dhe përfaqësimi IP-së Brenda dhe jashtë vendit;
- Sigurimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me donatorë;

- Realizimi vizitave studimore jashtë dhe Brenda vendit për qëllim të marrjes së përvojave;
- Sigurimi i hapsirave të mjaftueshme të punës dhe mjeteve për punë;
- Klasifikimi pozitiv të punës;
- Hartimi Rregullores për organizimin e brendshëm;
- Hartimi i metodologjisë për përzgjedhjen e kompanive me rrisht për të inspektuar;
- Rishikimi metodologjisë së mbledhjes së të dhënave sipas nevojës;
- Hartimi i platformës E-Inspektimi;
- Përfundimi i regjistrimit të pasurisë duke përdorur sistemin E-pasuria;
- Evidnetimi i të hyrave (nga gjobat) përmes sistemit dhe mbajtja azhure e të hyrave;
- Rritja e numrit të Inspektoreve plus 100 (Inspektor)
- Furnizimi me vetura si mjetë elementar për punë.

Objektivi 2: Avancimi i luftës kundër informalitetit, siguria dhe shëndeti në punë.

Në këtë objektivë synohet përmirësimi i procesit të Inspektimit për dy fushat që janë target në këtë objektivë e që konsistojnë në luftimin e Informalitetit dhe në krijimin e kushteve të shëndetshme në vendet e punës.

Në hartimin e kësaj objektivë është marrë për bazë gjendja faktike dhe nevoja për ndryshim të kësaj gjendje e cila koniston aktualisht me numër të madh të aksidenteve dhe me shkeljen e të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës.

Përmes kësaj objektivë synohet që përmes aktiviteteve konkrete të zvoglohet numri i aksidenteve në punë si dhe të luftohet puna informale pra puna në të zezë, duke bërë që të sigurohen kushte më të mira për punë të sigurtë dhe respektim të të drejtave nga marrëdhënia e punës.

Aktivitete që synohen të realizohen për arritjen e këtij objektivë:

- Realizimi i inspektimeve cilësore nga fusha e marrëdhënies së punës dhe siguria e shëndeti në punë;
- Rritja e numrit të inspektimeve në 40 inspektime në muaj, sipas parimit të inspektimeve në çift.
- Trajnimi inspektorëve për rastin e hyrjes në fuqi të ligjit për inspektimet dhe trajnimet tjera sipas planit;
- Konsistimi në përdorimin e e chek listave apo listave kontrolluese për sektor të caktuar;
- Organizimi i fushatave informuese/vetëdisuese përgaditja dhe shpërndarja broshurave;
- Mbledhja dhe përpunimi i sakt i të dhënave nga inspektimet;
- Hartimi i planit të veprimit për inspektimet;
- Hartimi i planeve mujore dhe vjetore të inspektimit.

Objektivi III Përmirësimi dhe zhvillimi i aftësive të stafit të IP-së

Realizimi i kësaj objektivë është i një rëndësie të veçantë në ngritjen dhe zhvillimin e aftësive të stafit të IP-së,

Nga gjendja faktike në IP deri më tani trajnimet nuk janë realizuar konformë me nevojat për trajnim që kanë pasur të punësuarit, kryesisht trajnimet e realizuara janë bërë sipas trajnimeve që janë ofruar nga jashtë qoftë si trajnim qoftë si punëtori.

Në kuadër të kësaj objektive problemet që do të adresohen konsistojnë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm të trajnimit të bazuar në analizën e nevojave reale për trajnim të stafit dhe të realizuara sipas një plani të përcaktuar dhe miratuar.

Tutje në kuadër të kësaj objektive do të adresohet edhe qështja e identifikimit dhe certifikimit të trajnerëve të brendshëm të cilët do të shërbenin për hartimin e moduleve të trajnimit dhe ofrimin e trajnimeve për stafin e ri, në rast të ndryshimit të legjislacionit dhe në cdo situatë tjetër konformë nevojës së identifikuar për trajnim si dhe gjithashtu ndërtimi i programeve të brendshme për trajnim do të ishte i një rëndësie të veçantë në zhvillimin profesional të stafit.

Indikatorët pas realizimit të kësaj objektive janë të qartë dhe tregojnë se është arritur të ndërtohet një sistem i qëndrueshëm i trajnimit, janë hartuar programe të brendshme për trajnim dhe po ashtu janë siguruar trajnerët e brendshëm.

Aktivitetet që synohet të realizohen në kuadër të kësaj objektive:

- Zbatimi i planit aktual të trajnimeve;
- Analizimi dhe identifikimi vazhdueshëm i nevojave për trajnim;
- Identifikimi i trajnerëve të brendshëm;
- Krijimi i programeve të trajnimit të brendshëm nga trajnerët në bashkëpunim me BNJ;
- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse nga fusha e trajnimeve;
- Menaxhimi i programeve SIMBNJ, SMAED, SVP, HRMIS, PAYROL E PAGAVE;
- Rishikimi i planit të trajnimeve për vitin 2023.

Objektivi IV: Avancimi i TI-së dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve të brendshme

Bazuar në gjendjen aktuale në IP proceset e punës të cilat kryhen ose mund të kryhen përmes TI-së nuk qëndrojnë në nivel të kënaqshëm, faqja zyrtare e IP-së nuk është edhe aq e pasuruar në atë mënyrë që të kryente funksionin e saj për të cilin është krijuar, po ashtu shërbimet të cilat ofrohen aktualisht ose kryhen në mënyrë manuale ose në raste edhe ka mungesë të të shërbimit si pasojë e mos organizimit të duhur por edhe mungesës së stafit. Problemet që do të adresohen në këtë objektiv konsistojnë në nevojën e përshtatjes së procesit të punës me teknologjinë bashkohore si futja në sistem e E-inspektimit, menaxhimi më i mirë i kontratave përmes E-prokurimit, krijimi i një platforme online për ankimim dhe njoftim të aksidenteve platformë e cila duhet të jetë e decentralizuar, ofrimi i informatave për punëdhënësit dhe të punësuarit përmes Web faqes, po ashtu në kuadër të kësaj synohet ndërtimi i shërbimeve të logjistikës.

Indikatorët pas realizimit të kësaj objektive, janë të qartë kalimi i proceseve të punës dhe dhënia e informacionit nga sistemi punës manual në elektronik.

Aktivitetet që synohet të realizohen janë:

- Hartimi i planit për rregullimin e gjendjes në arkiv (e-arkiva);
- Menaxhimi dhe administrimi buxhetit;
- Planifikimi i kërkesave bugjetore;
- Hartimi i planit të prokurimit publik;
- Hartimi raporteve financiare;
- Regjistrimi pasurisë në E-pasuria, Regjistrimi i të hyrave;
- Ridizajnimi i faqes së IP-së;

- Krijimi i platformës për pranimin online të ankesave dhe raportimeve të shëpërndar për të gjitha rajonet e IP-së;
- Ngritja e kapaciteteve në logjistikë;
- Vendosja e një udhëzuesi për procedurën e ankimimit;
- Publikimi dhe përditsimi i akteve ligjore dhe nën ligjore që mbikqyrën nga IP.
- Furnizimi me mjete pune si kompjuter paisje të tjera sipas kërkesës;
- Vendosja në Web faqe të informatave dhe sqarimeve, obligimeve dhe të drejtave për punëdhënës dhe punonjës.

Objektivi V: Ngritja Transparencës dhe marrëdhënia me publikun

Për të jetësuar parimin për administratë të hapur dhe transparente dhe për të ndërtuar një marrëdhënie të shëndoshë dhe profesionale me publikun është projektuar objektiva e 5 e cila synon të ngrisë transparencën dhe të rregulloj marrëdhënien me publikun duke siguruar transparencë dhe ofrim të informimit të sakt dhe në kohë reale.

Aktivitetet që synohen të realizohen në jetësimin e kësaj objektive janë:

- Sigurimi i informimit të rregullt të mediave dhe palëve të interesuara përfshirë edhe palët në procedurë pranë IP-së;
- Përditsimi i rregullt i Web faqes së IP-së me aktivitetet e rëndësishme të IP-së;
- Publikimi vendimve;

PLANI I PERFORMANCËS SË INSPEKTORATIT TË PUNËS – 2023

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi I: Fuqizimi rolit të IP-së						
1.	Treguesi i performances: Rritja e besueshmërisë	Nuk ka	Organ i mirëorganizuar.			
2.	Treguesi i performances: Eftkasitet në përmbushjen e mandatit	Nuk ka	Mandat i përmbushur me sukses.			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
1.1.	Bashkëpunimi me partnerët social dhe donatorë dhe përfaqësimi IP-së Brenda dhe jashtë vendit;	Zyra e Kryeinspektorit, DPSÇL	K1-K2-K3-K4	///	IP-Donator	Rritet numri i takimeve me partnerët.
1.2.	Sigurimi dhe nënshkrimi marrëveshjeve me donatorë	Zyra e Kryeinspektorit, DPSÇL, të tjerë sipas nevojës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Donatorë të siguruar, marrveshje të nënshkruara
1.3.	Realizimi vizitave studimore jashtë dhe Brenda vendit për qëllim të marrjes së përvojave;	Zyra e Kryeinspektorit, të tjerë sipas nevojës	K2-K3-K4	2.200,00 Euro, plus donator	IP-Donator	Marrja e përvojave dhe praktikave me të mira të rajonit.
1.4.	Sigurimi i hapsirave të mjaftueshme të punës dhe mjeteve për punë;	Zyra e Kryeinspektorit, DFSHP	K1-K2	15.990,00 Euro, plus Ministria pwrkatwse.	IP-Ministria pwrgegjiwse	Kushte të mira për punë, staf i akomoduar dhe i kënaqur
1.5.	Klasifikimi pozitive të punës;	Grupi punues	K3-K4	Nuk ka	IP	Pozita të klasifikuara

I.6	Hartimi Rregullores për organizimin e brendshëm	Grupi punues	K3-K4	Nuk ka	IP	Rregullore e finalizuar
I.7.	Hartimi I metodologjisë për përzgjedhjen e kompanive me risk për tu inspektuar	DPSÇL, Grupi punues	K2-K3	Donator	IP-Donator	Metodë e përzgjedhur dhe e miratuar.
I.8.	Hartimi platformës E-Inspektimi	Zyra e Kryeinspektorit, DPSÇL, DFSHP	K3-K4	Donator	Donator	E-inspektimi platformë e hartuar.
I.9.	Rishikimi metodologjisë së mbledhjes së të dhënave sipas nevojës;	DPSÇL, DKR, Inspektoret e Punës	K3	////	IP-Donator	Ndryshim i metodologjisë
I.10.	Regjistrimi i pasurisë duke përdorur sistemin E-pasuria	DFSHP, të tjerë sipas nevojës	K3	Nuk ka	IP	Pasuri e regjistruar.
I.11.	Evidencimi I të hyrave (nga globalat) përmes sistemit dhe mbajtja azhure e të hyrave	DFSHP	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Të hyrat janë të sakta dhe azhure
I.12.	Rritja e numrit të Inspektoreve plus 100 (Inspektor)	BNJ	K2-K3	720.000,00 Euro	IP	Mbulueshmëri me inspektime në tërë territorin e Kosovës.
I.13.	Furnizimi me vetura si mjetë I punës.	Zyra e Kryeinspektorit, Divizioni Prokurimit, DFSHP-ZKF	K2-K3	50.000,00 Euro	IP	Mjete pune të mjaftueshme
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin I: //////////////</i>					

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi II: Avancimi i luftës kundër informalitetit, siguria dhe shëndeti në punë.						
1.	Treguesi i performances: Zvogëlimi i aksidenteve në vendin e punës	405	Të zvoglohen aksidentet për 50%.			
2.	Treguesi i performances: Zvogëlimi i informalitetit në raport me vitin e kaluar.	356	Të zvoglohet informaliteti 50 %			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
2.1.	Realizimi i inspektimeve cilësore nga fusha e marrëdhënies së punës dhe siguria e shëndeti në punë.	Zyra e Kryeinspektorit, DKR, Inspektoret e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Në inspektim janë përfshirë në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat ligjore.
2.2.	Rritja e numrit të inspektimeve në 40 inspektime në muaj, sipas parimit të inspektimeve në çift.	DKR, Inspektoret e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Rritet numri i inspektimeve.
2.3.	Trajnimi inspektorëve për rastin e hyrjes në fuqi të ligjit për inspektimet dhe trajnimet tjera sipas planit.	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K2-K3	///	IP-IKAP-Donator	Krijimi i procedurave standarte i inspektimit.
2.4.	Konsistimi në përdorimin e e chek listave apo listave kontrolluese për sektor të caktuar.	DKR, Inspektoret e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Inspektim profesional dhe gjithëpërfshirës.

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi II: Avancimi i luftës kundër informalitetit, siguria dhe shëndeti në punë.						
1.	Treguesi i performances: Zvogëlimi i aksidenteve në vendin e punës	405	Të zvoglohen aksidentet për 50%.			
2.	Treguesi i performances: Zvogëlimi i informalitetit në raport me vitin e kaluar.	356	Të zvoglohet informaliteti 50 %			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
2.1.	Realizimi i inspektimeve cilësore nga fusha e marrëdhënies së punës dhe siguria e shëndeti në punë.	Zyra e Kryeinspektorit, DKR, Inspektorët e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Në inspektim janë përfshirë në mënyrë të detajuar të gjitha kërkesat ligjore.
2.2.	Rritja e numrit të inspektimeve në 40 inspektime në muaj, sipas parimit të inspektimeve në çift.	DKR, Inspektorët e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Rritet numri i inspektimeve.
2.3.	Trajnimi inspektorëve për rastin e hyrjes në fuqi të ligjit për inspektimet dhe trajnimet tjera sipas planit.	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K2-K3	///	IP-IKAP-Donator	Krijimi i procedurave standarde të inspektimit.
2.4.	Konsistimi në përdorimin e e chek listave apo listave kontrolluese për sektor të caktuar.	DKR, Inspektorët e Punës	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Inspektim profesional dhe gjithëpërfshirës.

	listave kontrolluese për sektor të caktuar.					
2.5.	Organizimi i fushatave informuese/vetëdijuese përgaditja dhe shpërndarja broshurave	Zyra e Kryeinspektorit, DPSÇL, DFSHP	K2-K3-K4	////	IP-Donator	Pundhënës, punëmarrës dhe partnerë social të vetëdijuesuar.
2.6	Mbledhja dhe përpunimi i sakt i të dhënave nga inspektimet	DPSÇL, DKR, Inspektoret e Punës	K2-K3-K4	////	IP	Të dhëna të sakta nga fusha e inspektimeve, bazë e mirë për analizë.
2.7	Hartimi i planit të veprimtimit për inspektimet	Zyra e Kryeinspektorit, DKR	K1	Nuk ka	IP	Plan i hartuar me standart dhe unik.
2.8	Hartimi i planeve mujore dhe vjetore të inspektimit	Zyra e Kryeinspektorit, DKR	K1	Nuk ka	IP	Plane mujore dhe vjetore të punës të hartuara.
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:</i>					

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi III: Përmirësimi dhe zhvillimi i aftësive të stafit të IP-së						
1.	Treguesi i performances: Dokumentet dhe vendimet e marra janë të justifikuar	Nuk ka të dhëna	Zvogëlimi i rasteve të këtyre në rishqyrtim nga gjykata dhe shkalla e dytë, per 20%			
2.	Treguesi i performances: Numri i trajnimeve është rritur	3-4	28 tema për trajnim			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
3.1.	Zbatimi i planit aktual të trajnimeve;	Divizioni i Burimeve Njerëzore, DPSÇL	K1-K2-K3-K4	////	IP-Donator	Plan i realizuar, staf profesional
3.2.	Analizimi dhe identifikimi vazhdueshëm i nevojave për trajnim;	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K1-K2-K3-K4	////	IP-Donator	Raport i analizës me nevoja.
3.3.	Identifikimi i trajnerëve të brendshëm;	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K3-K4	Nuk ka	IP	Trajaner të Identifikuar
3.4.	Krijimi i programeve të trajnimit të brendshëm nga trajnerët në bashkëpunim me BNJ;	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K4	////	IP	Programe specifike të trajnimit të hartuara.
3.5	Bashkëpunimi me institucionet përkatëse nga fusha e trajnimeve	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Rritje e cilësisë së trajnimeve.

3.6	Menaxhimi i programeve SIMBNJ, SMAED, SVP, HRMIS, PAYROL e PAGAVE	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Menaxhim modern i proceseve të punës.
3.7	Rishikimi i planit të trajtimeve për vitin 2023.	Divizioni i Burimeve Njerëzore	K3	Nuk ka	IP	Ofrimi i trajtimeve konform nevojave për trajnim.
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3</i>					

Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi IV: Avancimi i TI-së dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve të brendshme						
1.	Treguesi i performances: Ngritja e efikasitetit në proceset e punës	Nuk ka njësi matëse	Të gjitha aktivitetet realizohen.			
2.	Treguesi i performances: Shërbimet brenda IP-së përmirësohen		Të gjitha shërbimet jepen në kohë.			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
4.1	Hartimi i planit për rregullimin e gjendjes në arkiv (e-arkiva)	Zyra e Kryeinspektorit, DFSHP, të tjerë sipas nevojës	K2-K3	///	IP	Arkiv e organizuar dhe e digitalizuar.
4.2.	Menaxhimi dhe administrimi i buxhetit	Kryeinspektori, DFSHP dhe ZKF	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Buxhet i menaxhuar mirë.
4.3.	Planifikimi i kërkesave buxhetore	ZKF, DFSHP	K1	Nuk ka	IP	Kërkesat të planifikuara dhe procedurara për miratim.
4.4.	Hartimi i planit të prokurimit publik	Divizioni i Prokurimit	K1	Nuk ka	IP	Plan i miratuar konform nevojave.
4.5	Hartimi i raporteve financiare	ZKF	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Raporte të përfunduara.
4.6	Regjistrimi pasurisë në E-pasuria, regjistrimi i të hyrave	DFSHP	K1-K2	Nuk ka	IP	Pasuri e regjistruar në sistem.
4.7	Ridizajnimi i faqes së IP-së	DFSHP	K3-K4	///	IP	Faqe e dizajnuar.
4.8	Vendosja e një udhëzuesi për procedurën e ankimit;	DFSHP, DPSÇL	K3	Nuk ka	IP	Udhëzues i hartuar dhe i vendosur në sistem.

4.9	Ngritja e kapaciteteve në logjistikë.	DFSHP, Divizioni i Burimeve Njerëzore	K1-K2	20.000,00 Euro	IP	Logjistikë funksionale.
4.10	Krijimi i platformës për pranimin online të ankesave dhe raportimeve të shëpërndar për të gjitha rajonet e IP-së;	Zyra e Kryeinspektorit, DFSHP	K3-K4	////	Donator	Platformë funksionale e vendosur në web-faqen e IP-së.
4.11	Publikimi dhe përditësimi i akteve ligjore dhe nën ligjore që mbikqyrën nga IP.	DPSÇL, DFSHP	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Lista e publikuar e akteve nënligjore.
4.12	Furnizimi me mjete pune si kompjuter paisje të tjera sipas kërkesës;	Divizioni i Prokurimit, DFSHP	K1-K2-K3	35.000,00 Euro	IP	Furnizim i realizuar.
4.13	Vendosja në Web faqe të informatave dhe sqarimeve, obligimeve dhe të drejtave për punëdhënësin dhe punonjës;	DPSÇL, DFSHP	K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Faqja e furnizuar me të gjitha informacionet.
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin IV:</i>					

Nr.	Objektivat, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku			
Objektivi V: Ngritja transparencës dhe marrëdhënia me publikun						
I.	Treguesi i performances: Publik i kënaqur		Të gjitha palët të informuara në kohë			
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
5.1.	Sigurimi i informimit të rregullt të mediave dhe palëve të interesuara përshirë edhe palët në procedurë pranë IP-së;	Zyra e Kryeinspektorit	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Palë të informuara.
5.2.	Përditësimi i rregullt i Web faqes së IP-së me aktivitetet e rëndësishme të IP-së;	Zyra e Kryeinspektorit, DFSHP	K1-K2-K3-K4	Nuk ka	IP	Aktivitetet të vendosura në web faqe.
5.3.	Publikimi vendimeve;	Zyra e Kryeinspektorit, DFSHP, DPSÇL	K3-K4	Nuk ka	IP	Lista e vendimeve e publikuar.
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin V:						